



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 258/Prot.

Fier, më 27.02.2025

Projekt - Vendim

Nr. 25 dt. 27.02.2025

“Për dhënien e miratimit për prishjen e objektit “vendstrehim” me sipërfaqe 135 m², me nr. inventari 664, zk. 8531, që preket nga projekti “Shtesë anësore 1 kt në objekt ekzistues 3 kt, shkolla 9 vjeçare “Liri Gero” lagja “11 Janari” Fier, për ndërtimin e palestrës së shkollës si dhe nxjerrjen nga inventari të kësaj pasurie”

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .02.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, bazuar në nenin 54, shkronja “e/1” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, VKM nr. 574 dt. 28.05.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier Qarku Fier” i ndryshuar, VKM nr. 500 dt. 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” dhe VKM nr. 280 dt. 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtjes”, shkresë nr. 503/2 prot. dt. 31.01.2025 protokolluar në Bashki me nr. 1543 prot. dt. 04.02.2025 të Ministrisë së Mbrojtjes, **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

1. Dhënien e miratimit për prishjen e objektit “vendstrehim” me sipërfaqe 135 m², me nr. inventari 664, zk. 8531, që preket nga projekti “Shtesë anësore 1 kt në objekt ekzistues 3 kt, shkolla 9 vjeçare “Liri Gero” lagja “11 Janari” Fier, për ndërtimin e palestrës së shkollës”.
2. Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore për nxjerrjen nga inventari të kësaj pasurie, sipas përcaktimeve ligjore.

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria e hartimit të projekteve për investimet e huaja, vendase dhe integritet europian

Dr. H. Avdullai

Drejtoria Juridike

Drejtoresha: E. Kapllanaj

KRYETARI

Armando SUBASHI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËNKRYETARI

Vasil BREGU

